



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7709 Prot.

Roskovec, më 30, 08 2022

VENDIM

NR 57 .DATË 29 .08 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN KORRIK 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 27.07.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Korrik 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 7040/1 Prot.

Roskovec, më 28.07.2022

Procesverbal Nr.8

-I mbajtur sot, date 27.07.2022, ora 11⁰⁰, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Qershor 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2022.
5. Për anulim të pikës Nr.2 të Vendimit Nr.42 datë 29.06.2022 “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”.
6. Për përbërjen e Këshillit Vendor për Siguri Publike.
7. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.
8. Për miratimin e tavaneve përfundimtare të PBA-së 2023-2025.
9. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11¹⁰

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, L.Goga, B.Çobo, K.Hyska, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret mungojne
:E.Cepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, B.Kuka, T.Kuka, D.Hoxha, G.Hoxha, A.Sheme.

Prezent nga bashkia: Nenkryetari M.Goga, Dr.Finances, Sekretare e Pergjithshme, SP/Z/Sherbimit Social, Sp/Emergjencave Civile.

Me plotesimin e kuorumit ,zv/kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 11 keshilltare.Para se te filloje me mbledhjen,kryetari ben me dije se kemi disa projekte shtese nga administrata qe duhet ti fusim ne rendin e dites. “Per miratimin ne parim te projekt-propozimit “realizimi i projekteve ne fushat e energjise (efivences se energjise dhe energjive te rinovueshme RES),si dhe ndryshim ne buxhetin e vitit 2022 ne lidhje me miratimin e fondit me bashkefinansim nga B.Roskovec dhe Ministria e Shtetit per Mbrojtjen e Sipermaryes per projektin e shpallur fitues “AgROtech”.Sqaron se jane urgjente per ti futur ne rend per arsye te afateve ligjore.Hidhen ne votim materjalet e mesiperme per ti futur ne rendin e dites dhe miratohen unanimsisht me 11 vota pro.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites bashke me shtesat e bera si me siper dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Qershor 2022.

Informacioni i pregatitur nga sekretarja ka te bej me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar,ndarjen e akteve si dhe konfirmimin e Prefektures per aktet normative.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-30 Qershor 2022.

SP/Z/Ndhimes Ekonomike Sonila Rrapushi sqaron projektin dhe ndryshimet e sjella kete muaj.Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

5. Për anulim të pikës Nr.2 të Vendimit Nr.42 datë 29.06.2022 “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022”.

Dr.Finances sqaron projektin dhe arsyen e anulimit.Leksi-duhet te jeni me te vemendshem dhe mos i cenoni emergjencat civile.Hekurani-realisht ajo eshte shume problem per shkollen e Kumanit.Bujari-ketu thuhet pakesohet ose shtohet.Nenkryetari-ajo eshte pike tjeter skemi vajtur akoma atje.Hidhet ne votim anulimi i pikes Nr.2 te Vendimit Nr.42 date 29.06.2022 dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

6.Per perberjen e Keshillit Vendor per Siguri Publike.

Sp.Emergjencave Civile sqaron projektin.Leksi pyet kush i ka vendosur emrat.Specialisti jep sqarimet se disa pozicione i kemi sjelle vetem me emrin e pozicionit te punes sepse ndodh qe ndryshojne punonjesit.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

7.Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.(2 projekt-vendime)

Dr.Finances sqaron projektet.Sqaron se do te jene dy vendime te ndara per arsye se nje vendim eshte normative dhe tjetri nuk eshte vendim normativ.Dr.Finances sqaron me detaje projektet.Bujari-me shtohet ose pakesohet,projekti i Luarit eshte marr ne dorezim?20% e FSHZH ta heqim a kemi mundesi?kemi te drejte ne si bashki te nderhyjme?Dr.Finances sqaron se ne lidhje me pyetjen tende,kjo ka kaluar ne mbledhjen e pare jo ne kete mbledhje.Nenkryetari M.Goga sqaron Bujarin per projektin Luar-Siqece.Investimi i 100 fshatrave ka perfunduar,fondi prej 2.8 milion leke ska te bej fare me 100 fshatrat,ishte planifikuar per rrugen Luar-Siqece por nuk e kemi fituar projektin.Bujari-coni punonjesit se na mbyten ferrat.Dr.Finances sqaron fondin me bashkefinansim nga bashkia dhe MAS per investimin “Rikonstruksion i shkolles 9 vjecare 5 Deshmoret + kopesht,Suk 1,ambjente sportive dhe ndertim palestre”.Sqaron se financimi i bashkise do perballohet nga te ardhurat e 2023,si dhe do behen ndryshime ne PBA.Sqaron rishperndarjen e fondeve per rikonstruksionin e catise se shkolles Kuman dhe rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare 5 Deshmoret Suk 1.Sqaron fondet qe shtohen dhe pakesohen.Hidhet ne votim projektvendimi sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.(normativ) Dr.Finances sqaron projektvendimin e dyte ne lidhje me fondin e bashkefinansimit nga bashkia dhe Ministria e Shtetit per Mbrojtjen e Siper marrjes per projektin e fituar “AgROtech”.Sqaron se nga do perballohet ky fond ne buxhetin e vitit 2022.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

8.Per miratimin e tavaneve perfundimtare te PBA 2023-2025.

Dr.Finances sqaron projektin sipas materjalit te paraqitur.Sqaron tavanet perfundimtare te PBA 2023-2025 per bashkine dhe 2 njesite shpenzuese sipas formateve C1 dhe D1.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro.

9.“Per miratimin ne parim te projekt-propozimit “Realizimi i projekteve ne fushat e energjise (efivences se energjise dhe energjive te rinovueshme RES).

Nenkryetari sqaron projektin.Ky projekt kerkon nje 10% shtese te mbulohet nga bashkia.Dr.Juridike sqaron projektin.Duam te aplikojme per nje projekt per ndertimin e paneleve diellore afer stacionit te pompimit Metushaj dhe Hoxhenj Suk 1,ne pasurine pjese e fondit pyjor/kullosore.Kerkohet bashkefinancim ne vleren 10% te kostos totale e cila do te mbulohet nga bashkia.Viktori-per pjesen e energjise nuk kam asnje verejtje jam dakort,per shtrimin e rrugeve i ktheni pak syte edhe nga Marinza.Hidhet ne votim projekti i miratimit ne parim te projekt-propozimit “Realizimi i projekteve ne fushat e energjise” dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro.

10.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Viktori-ne Marinze nuk eshte bere asnje rruge.Maksi-rruga nga bukuroshja deri ne Marinze eshte bere,rruga tek shtepia e Arjan Markut eshte bere.Maksi-sot do lidhet kontrata per qendren e Marinzes.Vjollca-per cezmen e varrezave ne Mbers.Maksi-do futet ne tenderim e cila do dhe kohen e saj.Vjollca-per rruget ne fshatin Mbers?Maksi-eshte miratuar projekti per qendren e fshatit.Vjollca-rruget e brendshme ne fshat jane cope-cope.Anxhela-po behen disa punime tek depoja ne Strum,rruget jane bere cope-cope,nje shi te bieri ato do behen shume keq.Maksi-do ti mbushim menjehere.Alketi-per zjarret e rena ne parcelat poshte,ka dal njeri te bej verifikim se ca u jane demtuar fermereve serat,misri etj.Maksi-nese nuk eshte i siguruar prodhimi nuk futet tek fondi i emergjencave civile.Alketi-nuk ka ardhur asnje te bej nje verifikim se ca na u dogj.Alketi-kam bere nje ankese per kanal in vadites te betonit,nuk e keni zene me dore fare,pastruan vetem ferrat ne xhade dhe jo kanal in.Vjollca-ankese per shperndarjen e zarfave.Kete ankese e kane edhe disa keshilltare te tjere.Alketi-te vijne drejtorat ne mbledhje te na sqarojne per pyetjet qe kemi.Maksi-ne mbledhje vijne vetem ata qe kane paraqitur materjale per miratim,bej kerkese ne rast se do te vij ne mbledhje nje drejtor i caktuar.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska